



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është organizmi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë, i krijuar rreth 67 vjet më parë.

DPS përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizatat evropiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe interesat e të gjithë ekonomisë së vendit në hartimin dhe adoptimin e standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH). Hartimi dhe adoptimi i standardeve konsiston në nevojat që kanë ndërmarrjet prodhuese dhe të shërbimit, pavarësisht nga forma dhe madhësia e tyre, bizneset, qeveria dhe konsumatorët për t'i siguruar atyre standard, të cilat plotësojnë nevojat e tyre për cilësi dhe aftësi konkurruese më të madhe. DPS është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE).

Ajo bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera të infrastrukturës së cilësisë në vend duke i vënë atyre në dispozicion standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fuqi me objektivin që infrastruktura e cilësisë në Shqipëri të kryejë funksionet e saj sipas këtyre standardeve. DPS është institucion publik i njohur në nivel evropian e ndërkombëtar si organi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë në shërbim të ekonomisë dhe të të gjitha palëve të interesuara, duke u siguruar atyre standardet e të gjitha fushave. DPS-ja e realizon shitjen e standardeve duke u bazuar në tarifatat e miratuara nga Ministria e Financave pa qëllime fitimi. DPS është institucion publik i certifikuar sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001.

Ajo organizon punën për adoptimin dhe publikimin si standard shqiptare (SSH) e të gjitha standardeve me interes për ekonominë e vendit të publikuara nga organizatat evropiane të standardizimit CEN, CENELEC, ETSI, dhe ato ndërkombëtare ISO dhe IEC, duke i vënë ato në dispozicion të kujtdo që është i interesuar për përdorimin e tyre.

DPS angazhon çdo vit rreth 200 specialistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme si pjesë aktive e procesit të adoptimit të standardeve. E drejta e autorit për formën dhe përmbajtjen e do standardi shqiptar i takon DPS. Çmimi për një standard shqiptar varion nga 1190 lekë ÷ 25882 lekë dhe për bashkëpunëtorët çmimet shkojnë (me 50% ulje) nga 595 lekë ÷ 12941 lekë.

DPS, në varësi të nevojave të tregut, rishikon politikat e çmimeve dhe ia propozon ato Ministrisë së Financave për miratim.

Çmimet e standardeve shqiptare (SSH) janë afërsisht sa 30 % e çmimeve të standardeve ndërkombëtare. Si rezultat i kërkesave në rritje nga biznesi vendas për të prodhuar dhe shërbyer sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në fuqi, numri i standardeve të shitura nga viti në vit ka ardhur duke u rritur.

Ndër standardet më të kërkuara në botë është standardi ndërkombëtar ISO 9001 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, i cili është përdorur nga mbi 1 milion organizata në 178 shtete dhe ekonomi të ndryshme të globit.

Standardet më të kërkuara në Shqipëri janë standardet e ndërtimit, të naftës dhe benzinës (SSH EN 590 dhe SSH EN 228), standardet e menaxhimit të cilësisë SSHEN ISO 9001, SSH EN ISO/IEC17025 për kompetencën e laboratorëve të provave dhe të kalibrimit, etj.

DPS është anëtare me të drejta të plota në Institutin European të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI), anëtare me të drejta të kufizuara në Komisionin ndërkombëtar të Standardeve të Elektroteknikës (IEC), anëtare pa të drejtë vote në organizatat evropiane e ndërkombëtare të standardizimit CEN & CENELEC dhe ISO. DPS përfaqëson vendin në këto organizma. DPS-ja krahas të tjerave, ka

objektiv të saj kryesor, plotësimin e kushteve për t'u bërë anëtare me të drejta të plota në këto organizata dhe përmirësimin e punës së saj sipas modelit dhe praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Misioni i DPS-së

- Të organizojë gjithë veprimtarinë e standardizimit në vend në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e punës së organeve evropiane e ndërkombëtare të standardizimit (CEN & CENELEC, ETSI, ISO, IEC);
- Të plotësojë kërkesat e operatorëve ekonomikë vendas dhe palëve të tjera në vend për standardet e teknologjisë më të fundit në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së produkteve e shërbimeve vendase dhe reduktimin e barrierave teknike në
- tregti;
- Të rrisë ndërgjegjësimin publik për rolin që ka përdorimi i standardeve (EN) në sigurimin e cilësisë së jetës, kafshëve dhe mjedisit;
- Të ofrojë transparencë, gjithëpërfshirje dhe konsensus të të gjitha palëve të interesuara;
- Të plotësojë kushtet për t'u bërë anëtare me të drejta të plota në Komitetet Evropiane të Standardizimit, respektivisht CEN
- dhe CENELEC

Çfarë bëjnë Standardet?

Ato çojnë përpara ndryshimin, lehtësojnë arritjen e cilësisë, japin siguri, unifikojnë metodat e provave dhe procedurat dhe lehtësojnë në përgjithësi komunikimin duke përcaktuar çfarë është një "standard" për produktet dhe shërbimet. Standardet përgatiten nga ata që i zbatojnë ato në praktikë dhe që dinë ekzaktësisht se për çfarë janë ato. Standardet kontribuojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike të vendit.

Gjithashtu Standardet:

- inkurajojnë rritjen e ekonomisë;
- janë mjete në duart e prodhuesve për të zbatuar legjislacionin;
- inkurajojnë rritjen e konkurrencës;
- lehtësojnë tregtinë duke eliminuar pengesat teknike në tregti;
- sigurojnë nivelin e duhur ekologjik, qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e mjedisit.

Çmimet e standardeve

Tarifat dhe përfitimet; parashikuar në shkresën Nr. 15817/3 Prot. mbi “Miratimin e Tarifave”, nga Ministria e Financave datë 12.04.2016 sipas tabelës më poshtë:

Kodi (Grupi)	Numri i faqeve	Çmimi / lekë		Kodi (Grupi)	Numri i faqeve	Çmimi / lekë	
		Bashkëpunëtorë	Jobashkëpunëtorë			Bashkëpunëtorë	Jobashkëpunëtorë
A.	1 - 2	595	1190	XA.	101 - 120	3510	7021
B.	3 - 4	684	1368	XB.	121 - 150	3748	7497
C.	5 - 6	803	1606	XC.	151 - 180	4165	8330
D.	7 - 8	892	1785	XD.	181 - 210	4224	8449
E.	9 - 10	981	1963	XE.	211 - 240	4462	8925
F.	11 - 12	1130	2261	XF.	241 - 280	4789	9579
G.	13 - 14	1219	2439	XG.	281 - 320	5117	10234
H.	15 - 16	1338	2677	XH.	321 - 360	5444	10888
I.	17 - 18	1457	2915	XI.	361 - 400	5771	11543
J.	19 - 20	1547	3094	XJ.	401 - 475	6307	12614
K.	21 - 23	1695	3391	XK.	476 - 580	6723	13447
L.	24 - 26	1785	3570	XL.	581 - 690	7229	14458
M.	27 - 29	1874	3748	XM.	691 - 800	7764	15529
N.	30 - 32	1993	3986	XN.	801 - 920	8419	16838
O.	33 - 35	2082	4165	XO.	921-1050	9040	18080
P.	36 - 40	2201	4403	XP.	1051-1180	9698	19397
Q.	41 - 45	2321	4641	XQ.	1181-1290	10353	20706
R.	46 - 50	2469	4938	XR.	1291-1400	10977	21955
S.	51 - 60	2618	5236	XS.	1401-1580	11632	23264
T.	61 - 70	2856	5712	XT.	1581-1790	12286	24573
U.	71 - 80	3064	6128	XU.	1791-2000	12941	25882
V.	81 - 100	3272	6545				